

KOORDINATOR MARKETINGU – INTERNSHIP

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Implementimi dhe ekzekutimi i planeve të marketingut në përputhje me objektivat e kompanisë.
- Organizimi, zbatimi dhe monitorimi i fushatave promocionale (online & offline) dhe koordinimi me palët e jashtme, si agjencitë e marketingut, dizajnerët grafikë, qendrat tregtare ku zhvillojmë biznesin, etj., për të mbështetur suksesin e çdo fushate.
- Mirëmbajtja e kalendarit të aktiviteteve dhe koordinimi i përgatitjeve me departamentet përkatëse
- Ndjekja e krijimit dhe publikimit të spoteve televizive dhe radiofonike, si dhe materialeve të komunikimit online.
- Koordinimi dhe realizimi i fushatave të marketingut sipas udhëzimeve të partnerëve për brandet dhe multibrandet që përfaqësojmë, duke siguruar përputhjen me praktikën më të mirë të marketingut.
- Menaxhimi i materialeve reklamuese, si postimet në rrjete sociale, artikujt në blog dhe fushatat me email për të tërhequr dhe angazhuar audiencën.
- Përdorimi i platformave analitike (Google Analytics, Meta Business Suite, etj.) për të matur performancën.
- Bashkëpunimi me departamentet e tjera për të siguruar që strategjitë e marketingut mbështesin objektivat e kompanisë.

Aftësitë:

- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Njohuri të avancuara në fushën e marketingut.
- Aftësi të shkëlqyera në koordinim, planifikim dhe analizë të sjelljes së konsumatorit.
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, bashkëpunim në ekip dhe menaxhim të kohës.
- Kreativitet, fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion,
- Njohuri praktike në: Google Analytics, Google Ads, Facebook Ads

Edukimi dhe Kualifikimet:

- Diplomë Bachelor/Master Administrim Biznesi (Marketing përbën avantazh).
- Eksperiencë pune në fushën e marketingut ose komunikimit
- Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office (njohuritë e programeve të tjera kompjuterike përbëjnë avantazh)

Pas përfundimit me sukses të Internship-it (praktikës) dhe vlerësimit të performancës ofrohet mundësia e punësimit pranë kompanisë.

Kandidatët e interesuar për pozicionin e mësipërm, duhet të dërgojnë CV-në në adresën e-mailit: hr@balkansport.al ose WhatsApp: [+355677115111](tel:+355677115111).

Balkan Sport HR Team